

SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Në zbatim të neneve 21, 22 dhe 25 të ligjit Nr.152/2013 “Për NËpunësin Civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe VII të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 18/03/2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, shpall procedurën për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive për pozicionin;

1 (një) Specialist i Dokumentimit të Seancave, në Sektorin e Dokumentimit të Seancave në Drejtorinë e Njesisë së Mbështetjes së Komisioneve, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Kategoria e pagës: IV-1.

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton vakant, do të jetë i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE
04/12/2023

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
08/12/2023

- Të kryejë veprimet procedurale e teknike për përgatitjen e seancës dhe sigurojë mbështetje për përgjegjësën e sektorit, për mbarëvajtjen e seancës dhe zbatimin e Rregullores së Këshillit të Lartë të Prokurorisë lidhur me procedurat në seancë;
- Të zbardhë me përpikmëri konceptuale ligjore, logjike dhe gjuhësore, procesverbalet e seancave plenare dhe të sigurohet që ato të jenë në përputhje me udhëzimet e eprorëve;
- Të respektojë dhe garantojë zbatimin e koncepteve gjuhësore, rregullave semantike e drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë redaktimit të procesverbaleve dhe shkresave përcjellëse, sipas formatit të duhur, numërtimit të tyre sipas rregullave të protokollit, përfshirë dhe dokumentet për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë në seancë plenare;
- Të administrojë të gjithë dokumentacionin që lidhet me procesin (relacionet, projektvendimet), si dhe të dhënat për ecurinë e seancave, duke u kujdesur të përditësojë çdo ndryshim të mundshëm sipas rregullave;
- Të zbatojë Rregulloren e Brendshme të institucionit për dorëzimin e punës në kohë dhe me cilësi;
- Planifikon punën për mbarëvajtjen dhe redaktimin e procesverbalit të mbledhjeve plenare në mënyrë korrekte, përfshirë paraprakisht axhendën, si dhe materialet që do të miratohen;
- Bashkëpunon me stafin për arritjen sa më mirë të objektivit të punës lidhur me zbardhjen korrekte të procesverbalit si dhe të materialeve të tjera, si shkresa përcjellëse, kthim përgjigje etj.;
- Kujdeset për mbarëvajtjen e punës, referuar rregullave të etikës profesionale dhe të sjelljes korrekte me kolegët, eprorët, referuar dispozitave të ligjit nr.9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” dhe akteve përkatëse nënligjore në dhe për zbatim të tij;
- Trajtimi dhe ruajtja e sekretit për të gjitha materialet që hyjnë ose dalin nga institucioni, duke u kujdesur për t’i siguruar ato sipas rregullave;
- Të kujdeset për mbarëvajtjen e punës, referuar rregullave të etikës profesionale dhe të sjelljes korrekte me kolegët dhe eprorët.
- Bashkëpunon me përgjegjësën e sektorit për marrjen dhe shpërndarjen, e materialeve të korrespondencës, në drejtoritë dhe sektorët e tjerë;

1. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

I. Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta

I.1. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të plotësojë të gjitha kushtet e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, sipas nenit 21 e 22, të ligjit Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” të ndryshuar;
- b) Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);

- c) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- d) Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

I.2. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta.

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit "Master" në Shkenca Juridike/ Shoqërore, ku edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b) Të paktën 1 (një) vit përvojë pune në profesion;
- c) Të ketë njohuri në një nga gjuhët e BE-së (preferohet anglisht);

I. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës 04.12.2023, me postë në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga: “Ana Komnena”, godina Poli i Drejtësisë, Tiranë, ose elektronikisht në adresën e email: info@klp.al, kopje të dokumenteve si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron;
- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- Fotokopje e diplomës dhe listës së notave (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njësimi nga MAS);
- Fotokopje të librezës së punës;
- Dokument për kategorinë në shërbimin civil (kategoria ekzekutive, me dokument nga institucioni);
- Dokument që nuk ka masë disiplinore në fuqi, (dokument nga institucioni);
- Vlerësimin e fundit të rezultateve në punë;
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Dëshmi penaliteti ose Vetëdeklarim për vërtetimin e gjendjes gjyqësore, sipas linkut https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/formulari-i-vetdeklarimit_gjendja-gjyqesore.pdf
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Dëshmi të njohurive të gjuhës së huaj;
- Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës;
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit;
- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ka çështje në proces.

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara sjell skualifikimin e kandidatit.

III. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak.

III.1. Verifikimi paraprak, i përmbushjes së kushteve të përgjithshme dhe kriterëve të veçanta në shpalljen për konkurim, do të kryhet brenda datës 06.12.2023, në ambientet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe brenda ditës do të shpallet lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, të shpalljes për konkurim.

- Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, do të njoftohen nëpërmjet adresës së e-mailit për shkaqet e mos kualifikimit të tyre;
- Shpallja do të bëhet në faqen zyrtare të internetit, të KLP-së dhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit;

IV. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurrimi.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

1. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
2. Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
3. Rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
4. Njohuri mbi ligjin nr. 9367, datë 07.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;
5. Njohuri mbi ligjin nr.9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

V. Aftësi për të:

- a) Aftësi për të zbardhur dhe redaktuar saktë, në kohë e me cilësi, materialet e seancave plenare;
- b) Aftësi për të shkëmbyer ide dhe mendime për qartësimin e thelbit të diskutimeve si dhe njohuri profesionale në hartimin/redaktimin e shkresave përcjellëse dhe numërtimin e materialeve, duke respektuar rregullat e protokollit dhe afatet ligjore në kryerjen e detyrave konkrete të sektorit që mbulon;
- c) Njohuri në fushën e legjislacionit (ligjit nr.115/2016 “Për qeverisjen e organeve të sistemit të drejtësisë”, ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit nr.9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”), si dhe normave letrare të drejtshkrimit dhe procedurave sipas veprimtarisë që mbulon sektori i dokumentimit të seancave;
- d) Aftësi të komunikimit
- e) Fleksibilitet në oganizimin, bashkëpunimin, komunikimin dhe prezantimin shërbimit të tij/saj, me metoda të reja që nuk bien ndesh me ligjin dhe dinjtetin e punonjësit.

VI. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar: Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin

pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

VII. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të KLP-së dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

2. PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ky pozicion është vakant, atëherë ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë duke filluar nga data **11.12.2023**.

2.1 Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 20, 21 dhe 22 të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II të Vendimit, të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 18/03/2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”,

2.2 Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

- f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

2.3 Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta, si vijon:

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit "Master" në Shkenca Juridike/ Shoqërore, ku edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b) Të paktën 1 (një) vit përvojë pune në profesion;
- c) Të ketë njohuri në një nga gjuhët e BE-së (preferohet anglisht);

3. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës 08.12.2023, me postë në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga: “Ana Komnena”, godina Poli i Drejtësisë, Tiranë, ose elektronikisht në adresën e email: info@klp.al, kopje të dokumenteve si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron;
- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- Fotokopje të diplomës (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Vlerësimin e fundit të rezultateve në punë;
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Dëshmi Penaliteti ose Vetëdeklarim për vërtetimin e gjendjes gjyqësore, sipas linkut: https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/formulari-i-vetdeklarimit_gjendja-gjyqesore.pdf
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Dëshmi të njohurive të gjuhës së huaj;
- Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës;
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ka çështje në proces.

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara sjell skualifikimin e kandidatit

4. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 19/12/2023, KLP do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga KLP, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

5. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurrimi.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- a. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- b. Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- c. Rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- d. Njohuri mbi ligjin nr. 9367, datë 07.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;
- e. Njohuri mbi ligjin nr.9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

V. Aftësi për të:

- a) Aftësi për të zbardhur dhe redaktuar saktë, në kohë e me cilësi, materialet e seancave plenare;
- b) Aftësi për të shkëmbyer ide dhe mendime për qartësimin e thelbit të diskutimeve si dhe njohuri profesionale në hartimin/redaktimin e shkresave përcjellëse dhe numërtimin e materialeve, duke respektuar rregullat e protokollit dhe afatet ligjore në kryerjen e detyrave konkrete të sektorit që mbulon;
- c) Njohuri në fushën e legjislacionit (ligjit nr.115/2016 “Për qeverisjen e organeve të sistemit të drejtësisë”, ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit nr.9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”), si dhe normave letrare të drejtshkrimit dhe procedurave sipas veprimtarisë që mbulon sektori i dokumentimit të seancave;
- d) Aftësi të komunikimit
- e) Fleksibilitet në organizimin, bashkëpunimin, komunikimin dhe prezantimin shërbimit të tij/saj, me metoda të reja që nuk bien ndesh me ligjin dhe dinjitetin e punonjësit.

6. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

6.1. Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) - Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;

- b) - Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c) - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

VII. Mënyra e vlerësimit do kryhet sipas neneve 21, 22 të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II të Vendimit, të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 18/03/2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e proves dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar”.

VII.- Data e zhvillimit të konkurrimit

Data e testimit me shkrim do të shpallet në faqen të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLP-së, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimin në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;

- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e KLP-së duke filluar nga data 19/12/2023

Tiranë, më 23.11.2023